

UDHËZIM
Nr. 4, datë 21.2.2013

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2013

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore të jenë:
 - a) Gjuhë shqipe dhe letërsi 31 maj 2013;
 - b) Matematikë 14 qershor 2013;
 - c) Provime me zgjedhje 29 qershor 2013.

Neni 2

Masa për mbarëvajtjen e provimeve

1. Çdo DAR/ZA të dërgojë brenda datës 23 maj 2013 në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP), emrat e nxënësve maturan të mbetës në përfundim të këtij viti shkollor, për t’u hequr nga lista e provimeve të Maturës Shtetërore.
2. Për provimet e Maturës Shtetërore të ndiqen procedurat e përcaktuara sipas “Rregullores për procesin e Maturës Shtetërore 2013 në Republikën e Shqipërisë”, nr. 35 prot., datë 7.1.2013.
3. Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore të shfrytëzohen edhe mjedise të institucioneve të arsimit të lartë publik.
4. Organizmi i konsultimeve me maturan të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011 “Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturan të”. Teza e provimit “Gjuhë dhe letërsi greke” për shkollën e mesme pedagogjike të minoritetit grek të përgatitet nga DAR Gjirokastrë.
5. Tërheqja e testeve të provimeve me shkrim të Maturës Shtetërore të bëhet sipas grafikut të hartuar nga AKP dhe të miratuar nga MASH.

Neni 3

Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore

1. Provimet e Maturës Shtetërore 2013, të detyruara dhe me zgjedhje, të fillojnë në orën 10:00.
2. Procedurat e hartimit të testeve të provimeve të detyruara dhe atyre me zgjedhje përcaktohen në “Rregulloren për procesin e Maturës Shtetërore 2013 në Republikën e Shqipërisë”, nr. 35 prot., datë 7.1.2013.
3. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa të jenë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.
4. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.

5. Provimet e detyruara të zgjasin 2 orë e 30 minuta secila.
6. Provimet me zgjedhje të zgjasin 3 orë. Maturantët/kandidatët që do të japin provim të MASH-së njëherë nga lëndët me zgjedhje, do të fillojnë provimin në orën 11:00 dhe do ta përfundojnë atë në orën 13:00. Ata do ta zhvillojnë provimin në mjedise të veçanta.
7. Maturantët/kandidatët mbetës në provimet e Maturës Shtetërore kanë të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.

Neni 4

Administrimi i provimeve

jhhn

1. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2013 të bazohet në “Rregulloren për procesin e Maturës Shtetërore 2013 në Republikën e Shqipërisë”, nr. 35 prot., datë 7.1.2013.
2. DEPU dhe AKP, brenda muajit mars 2013, të përcaktojnë sasinë dhe llojin e testeve që nevojiten për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje).

Neni 5

Dispozita të fundit

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Edukimit Parauniversitar, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj